


PA DEMOKRACI S'KA LIRI



DEMOKRACIA NË VENDIN TONË

FATLIND (11), ELMA (10), FATJON (10), ELHAME (10), ARLIND (10), MEDINA (10), KADRI (10)



Ne në Kosovë e kemi demokracinë përfaqësuese, ku rol përfaqësues kanë deputetët e Kuvendit të Kosovës

Demokrati do të thotë qeverisje e popullit. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke. Demokracia lindi në vitin 507 në Athinë (kryeqytetin e Greqisë). Më parë njerëzit nuk kishin të drejtën e të shprehurit lirshëm, nuk kishin të drejtën e lirisë dhe nuk kishin të drejtën e shkollimit. Tash, kemi të drejta të plota dhe liri. Demokracia ka disa elemente: tolerancën, drejtësinë, respektin, barazinë, paqen, solidaritetin, mendimin e lirë, etj. Demokracia ka shumë forma, por më të rëndësishme prej tyre janë: forma e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese.

Ne në Kosovë kemi grupin parlamentar, që do të thotë se në vendin tonë funksionon demokracia përfaqësuese. E këta përfaqësues ne i quajmë deputetë, të cilët ne i zgjedhim përmes votave.

Neve na pëlqen demokracia sepse ajo na ofron shumë të drejta. Ne e kemi të drejtën e shkollimit dhe nuk e keqpërdorim atë sepse ne mësojmë dhe i kryejmë detyrat me rregull.

Një e drejtë tjetër, është e drejta e argëtimit, ku edukatorët e punëtorisë ku jemi sot na dhanë mundësi që të zhvillojmë aktivitete të ndryshme dhe përmes tyre kemi mësuar shumë gjëra për demokracinë, si ta respektojmë njëri-tjetrin, t'i hedhim mbeturinat në vendet e caktuara, t'i ndihmojmë njerëzit me nevoja të

veçanta ose të tjerët që kanë nevojë për ne.



E tashmja dhe e ardhmja e popullit




Të barabartë pa dallime

NE, JEMI NDRYSHIMI

BLEART (11), BLEON (11), ERIS (10), ENES (10), ELMEDINA (10), KALTRINA (10), RINESA (10),

TRINGA (10)



Zgjedhjet në demokraci nuk janë luftë për ekzistencë, por mundësi për t'i shërbyer shoqërisë sa më mirë

Për t'i kuptuar më mirë zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre, grupi ynë sot ka mbajtur zgjedhje brenda grupit të vogël. Si u zhvilluan ato zgjedhje, do t'iu informojmë në vazhdimësi të artikullit.

Pasi grupi ynë përbëhej nga tetë nxënës dhe secili prej nesh kishte dëshirë të shkruante në kompjuter, ne vendosëm që të votojmë për secilin nga ne. Ne votuam për atë që mendonim se do të shkruante më së shpejti dhe pa gabime. Pra, votat ishin të lira, të drejta, por më e rëndësishja ishte se votat ishin të fshehta. Askush nga ne nuk e dinte se për cilin votonin shoku/shoqja. Në këtë mënyrë, ne u munduam që t'i kuptojmë më mirë dhe më qartë zgjedhjet dhe votat, si dhe rëndësinë e tyre.

Për t'i kuptuar akoma më shumë zgjedhjet ndoshta është më mirë të ndalemi pak edhe tek nëntitulli që kemi shkruar më lart. Ne nga ky nëntitull kuptojmë që demokracia është ai sistem i qeverisjes i cili iu mundëson të gjithë qytetarëve t'ia japin votën atij apo asnjë që do t'i bindë dhe do t'i përfaqësojë interesat e tyre. Pra, zgjedhjet në demokraci na mundësojnë një jetë sa më të mirë.

Vendi ynë Kosova, ka zgjedhje demokratike sepse qytetarët janë të lirë të votojnë për atë që mendojnë që do t'i përfaqësojë në mënyrën më të mirë të mundsh-


me. Qytetarët e Kosovës, të drejtën e votës e gëzojnë pasi të arrijnë moshën 18 vjeçare, sepse atëherë janë të aftë të gjykojnë drejt se kush e meriton të jetë përfaqësues i popullit. Kemi dy lloje zgjedhjesh, zgjedhjet qendrore dhe ato lokale.

Në zgjedhjet qendrore qytetarët votojnë për deputetët, ndërsa në zgjedhjet lokale votohet për kryetarin e komunës si dhe asambleistët.

Një gjë që ka shumë rëndësi është se kur zgjedhjet përfundojnë, ata të cilët nuk arritën të fitojnë shumë vota duhet ta pranojnë gjykimin e drejtë të qytetarëve. Për shembull, nëse partia e cila ka pasur pushtetin për katër vjet humb në zgjedhjet e fundit atëherë, në mënyrë paqësore duhet të dorëzojë pushtetin tek ata të cilët kanë fituar me së shumti vota. Kjo pra të dashur lexues, quhet demokraci sepse në demokraci, të gjithë janë të barabartë, por gjithmonë fiton më i miri dhe më i drejti për popullin.




Autorët e artikullit të zgjedhjeve




Këtu kemi paraqitur pemën e demokracisë



Një zgjedhje e përditshmërisë sonë



Kandidatët për deputetë



Disa nga funksionet e Kuvendit të Kosovës



Unë dhe shoku im jemi qytetarë aktiv



Ne, jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik

KUVENDI NË VENDIN TONË DEMOKRATIK

ERION (10), SUELA (10), ERJON (10), ELMA (10), VENIS (11), EDI (10), ENESA (10)

Populli e ka fjalën kryesore në demokraci sepse qytetarët me anë të votës së lirë, në zgjedhje të lira, zgjedhin deputetët të cilët e përfaqësojnë popullin

Demokracia është pushtet i popullit. Si mund të jetë demokracia pushtet i popullit? Është shumë e thjeshtë, populli e ka fjalën kryesore në demokraci sepse qytetarët me anë të votës së lirë në zgjedhje të lira, zgjedhin deputetët të cilët e përfaqësojnë popullin. Këta deputetë punojnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e Popullit“. Deputetët që punojnë aty, kanë shumë përgjegjësi dhe detyra. Ata përveç se e zgjedhin Qeverinë dhe Presidentin e shtetit, kanë edhe njërën nga detyrat kryesore, e që është miratimi, shfuqizimi dhe propozimi i ligjeve.

Përgjegjësi e deputetëve të Kuvendit është që sa më mirë të përfaqësojnë shtetin dhe popullin.

Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë shqiptarë, kurse 20 janë të komuniteteve jo shumicë, si romë, ashkali, serbë, boshnjakë, turq dhe egjiptianë. Sipas ligjit, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, 30 % e ulëseve janë të garantuara për deputetet gra.

Ne jemi të lumtur që jetojmë në një shtet demokratik dhe të pavarur, ku Kuvendi i bën ligjet për të mirën tonë. Qeveria i ekzekuton ligjet, kurse qytetarët i zbatojnë ato.

Unë e mësova se një funksion i Kuvendit është funksioni përfaqësues, sepse përfaqëson popullin.




Elma duke biseduar me Erijonin

Po është e vërtetë Elma. Por, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera, të cilat janë funksioni legjislativ, sepse i bën ligjet dhe funksioni kontrollues, sepse kontrollon Qeverinë.



Erijoni i spjegon Elmës dy funksione të Kuvendit



Funksionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës



Gazetarët e rinjë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-7
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë